

KONTRATE

Kjo Kontratë është lidhur sot më **25.01.2016**, midis **Bashkia Keqyre** me përfaqësues Kryetarin e Bashkisë, **z.Klement Ndoni**, tani e tutje të referuar si "Autoriteti Kontraktor" dhe "**Hito 94 shpk & Leon Konstruksion shpk**", perkatesisht me NIPT J691022060 me seli ne Keqyre, me drejtues ligjor z Arben Hodo, dhe Leon Konstruksion me NIPT K718200091 me drejtues ligjor z Gentjan Molla me seli ne Tirane tani e tutje i quajtur si "Kontraktuesi" me prokur përfaqësimi nga Hito 94 sh.pk.

1-Objekti i Kontrates: : ""Sistemim asfaltim unaza Keqyre Qender Faza e dyte sipas projekt zbatimit qe gjendet ne DT

2-Vlera e Kontrates: : **7 828 195 (shtatemilion e teteqind e njezetee tete mije e njeqind e nentedhjet e pese) leke pa tvsh dhe 9 393 834 leke me tvsh**

3-Baza Ligjore: Ligji 9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" V.K.M nr.914 date 29.12.2014 "Per Miratimin e Regullave te Prokurimit Publik", I ndryshuar, Udhezimet e Agjensise se Prokurimit Publik per dokumentacioni standart te prokurimeve,ligji 8402 date 10.09.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit",Indryshuar, Udhezimi nr.3 date 15.02.2001 "Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit", Ligjit 8652 date 31.07.2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore".Kodi Civil I R.SH , Kodi i Procedurave Administrative .

4-Afati i fillimit te punimeve do te jete **data 25.01..2016** dhe ajo e mbarimit te punimeve do te jete jo me vone se **30 dite kalendarike**

5-Te drejtat dhe detyrimet e paleve.

5.1-Te drejtat dhe detyrimet e autoritetit kontraktor.

1-Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e hyrjes të shprehur në dokumentat e tenderit. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktorit i lind e drejta të kërkoje amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.

2-Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me perjashtim te rastit kur keto te fundit, kishin gabime te dukshe qe mund te ishin konstatuar lehtesisht nga kontraktuesi.

3- Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.



4-Autoriteti Kontraktor me shpenzimet e tij, ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet. Nëse materialet prodhohen ose përgatiten në vende të ndryshme nga ato të kontraktorit, kontraktori duhet të sigurojë leje për Autoritetin Kontraktor për të ndjekur këto testime dhe inspektime.

5- Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo Punim që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.

6-Pagesat do të behen siç specifikohet në kushtet e vecanta të kontratës. Pagesa do të bëhet me monedhë Shqiptare . Pagesa do të behet në nr e llogarise të kontraktuesit , pas paraqitjes së situacionit të konfirmuar nga supervizori i caktuar nga autoriteti kontraktor

7-Autoriteti kontraktor nuk do të paguaje paradhenie .

8- Autoriteti Kontraktor do të jetë dakort për një zgjatje të afatit, në rastin e Forcës Madhore.

9-Garanci e difekteve do të mbahet në masën 5% të vlerës së kontratës , për një periudhë 1 (një) vit nga data e përfundimit të objektit sipas datës së procesverbalit të marrjes në dorezim të punimeve.

5.2. Te drejtat dhe detyrimet e kontraktorit:

1- Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje të plote me projektin e zbatimit , afatin dhe me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.

2- Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhë atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

3- Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë si dhe ruajtjen e mjedisit të gjitha aktivitetëve në kantier.

4- Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për kontrollin e cilësisë dhe zbatimin e kontratës.

5-Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit, kontraktori do të jetë përgjegjës për dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë, dhe pasuri të tjera dhe që nuk mbulohen nga Autoriteti Kontraktor .

6- Çmimet e kontraktorit për Punët e kryera sipas kontratës nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga kontraktori në ofertën e tij.

6-Te Përgjithshme.

1-Kontrata do të rregullohet , interpretohet dhe zbatohet sipas bazës ligjore që ka shëryer si bazë për lidhjen e saj dhe me gjëra të ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

2-Bashkëngjitur kësaj kontrate do të jenë:

-Projekti , specifikimet teknike dhe DT ,

-Kushtet e përgjithshme të kontratës;

-Kushtet e vecanta të kontratës:



-Preventivi fitues

- Sigurimi i kontrates

7-Zgjidhja e mosmarreshjeve.

1-Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrveshje me negociata direkte.

2-Në se palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrveshjes ose konfliktit, ato i drejtohen zgjidhjes së marrveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Autoriteti Kontraktor

Bashkia Kelcyre

KRYETARI

Klement Ndoni



Kontraktuesi

"Hito 94" sh.p.k

ADMINISTRATORI

Arben Hodo

